**VENDIM**
**Nr.13, datë 9.3.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN**
**"PËR KREDINË KONSUMATORE DHE KREDINË HIPOTEKARE PËR INDIVIDËT"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe të nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pikës 2 të nenit 124 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të nenit 44 pika 4 të ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët", miratuar me vendimin nr.5, datë 11.2.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 6, paragrafi 2 shkronja "f" ndryshohet si më poshtë:

"f)… vlerën e këstit, numrin e kësteve dhe periodicitetin e shlyerjeve të kësteve (pagesave), si dhe të paraqitet një plan i shlyerjes së kredisë duke përfshirë totalin e detyrimit (kryegjë dhe interes) për të gjithë kredinë.".

b) Në nenin 7, paragrafi 1, shkronja "h" ndryshohen si më poshtë:

"h)… shumën e këstit, numrin dhe periodicitetin ose datat e çdo kësti (pagesave të konsumatorit) për të shlyer kredinë, dhe çdo shpenzim tjetër lidhur me dhënien dhe përdorimin e kredisë, të paraqitur në një plan shlyerjeje të kredisë (kryegjë dhe interes)".

c) Në nenin 12, fjalia e parë e paragrafit 1 ndryshon si më poshtë:

"Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, edhe para afatit të maturimit, shlyerje të pjesshme ose të plotë të detyrimeve të tij të lindura nga kontrata e kredisë konsumatore.

d) Në nenin 12, shtohen paragrafët 2, 3 dhe 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Në rastin e shlyerjeve të kredisë para afatit, banka ka të drejtën për një kompensim të drejtë dhe objektiv, për kosto të mundshme të lidhura direkt me shlyerjen/et e kredisë para afatit, me kusht që shlyerja para afatit t'i përkojë një periudhe, për të cilën norma e interesit është fikse, sipas përcaktimit në kontratën e kredisë.

3. Nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit, kompensimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, nuk tejkalon 2 për qind të shumës së kredisë së paguar para afatit dhe nëse kjo periudhë nuk kalon 1 vit, kompensimi nuk tejkalon 1 për qind të shumës së kredisë së paguar para afatit.

4. Kompensimi për shlyerjet e parakohshme nuk aplikohet në rastet e mëposhtme:

i) nëse shlyerja realizohet në bazë të një kontrate sigurimi, e cila ka si qëllim shlyerjen e kredisë;

ii) për kredinë kufi (*overdraft-in*); dhe

iii) nëse shlyerja e kredisë para afatit i përkon një periudhe, për të cilën norma e kredisë nuk është fikse.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e ndryshimeve dhe shtesave të rregullores "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare për individët", të miratuar me këtë vendim në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Adrian Fullani**